# Worcester Public Schools

## Kalimi i Distriktit në Planin Hibrid të të Mësuarit

### Udhëzime & Protokolle për Rihapjen e Shkollave

Shkurt 2021

**Drejtore e Përgjithshme:**
Maureen Binienda

Durkin Administration Building
20 Irving Street
Worcester, MA 01609
508-799-3117



**Komiteti i Shkollës:**
Mayor Joseph M. Petty
Dianna L. Biancheria
Laura Clancey
John L. Foley
Molly O. McCullough
John F. Monfredo
Tracy O'Connell Novick

Të dashura Familje,

Nuk do të kishim menduar asnjëherë një vit më parë, se WPS do të praktikonte mësimin në distancë për një vit. Familjet e WPS kanë bërë një punë të jashtëzakonshme përgjatë këtij viti shkollor, unik dhe sfidues. Përmes përpjekjeve të të gjithëve, ne kemi punuar së bashku për t'u siguruar nxënëseve dhe nxënësve tanë mjetet dhe njohuritë për të përmirësuar për ta procesin e mësimindhënies. Ne u kemi mundësuar një mjedis të përshtatshëm për mësimin në distancë. Secilit nxënës/e i është siguruar një iPad ose Chromebook. Në partneritet me familjet dhe aktorët e komunitetit, kemi punuar së bashku për të mundësuar qasjen e nxënësve/eve në internet. Në partneritet me Menaxhimin e Qytetit dhe Kryetarin/en e Bashkisë, sistemet e jonizimit dhe HVAC janë rinovuar në të gjitha shkollat tona. Shërbimet ushqimore të WPS kanë vazhduar të ofrojnë ushqime të përditshme për familjet tona. Agjencitë e komunitetit dhe specialistët e të mësuarit social-emocional të WPS-së u kanë siguruar mbështetje nxënësve/eve dhe familjeve tona. Drejtorët dhe drejtoreshat e WPS-së, mësuesit/et dhe familjet tregojnë për një lidhje më të fortë me njëri-tjetrin, duke punuar së bashku për të përmbushur nevojat e nxënëseve dhe nxënësve tanë.

Të enjten, më 4 Shkurt 2021, Komiteti i Shkollës Worcester votoi për të rihapur shkollat tona, për të mësuarin hibrid. Mësimi në distancë gjithashtu do të vazhdojë të mundësohet. Më 15 Mars, 2021, do të rihapim shkollat për nxënës/e me aftësi ndryshe dhe komplekse, si edhe për nxënëset/it tanë me arsim të kufizuar (SLIFE), pjesë e Programeve tona të Qendrës së Qytetarëve të Rinj/Reja. Më 29 Mars, 2021, shkollat do të rihapen për të gjithë nxënësit/et e tjera që kanë zgjedhur mësimin hibrid.

Ky dokument u paraqitet familjeve tona, për të dhënë udhëzime lidhur me një rihapje të sigurt dhe të suksesshme të shkollës. Unë po ju ftoj, gjithashtu të merrni pjesë në një nga tre forumet familjare virtuale nga ora 18:00-19:30, ditën e hënë, 22 Shkurt për familjet që flasin spanjisht; nga ora 17:30-19:30, më datë 1 Mars, për familjet e nxënësve/eve me aftësi ndryshe dhe komplekse dhe për ata/ato që ndjekin Programet tona të Qendrës së Qytetarit/es se Re dhe në 15 Mars për të gjitha familjet e tjera, që kanë zgjedhur mësimin hibrid.

Unë do të vazhdoj t'ju informoj mbi udhëzimet aktuale nga Departamenti MA i Arsimit Fillor dhe të Mesëm, duke postuar përditësime në faqen tonë të internetit, worcesterschools.org, si edhe përmes mediave sociale dhe mesazheve telefonike Connect-Ed.

Faleminderit për mbështetjen tuaj të vazhdueshme.

Maureen Binienda

*"Nëse të gjithë ecim përpara së bashku, atëherë suksesi kujdeset vetë për veten".* -Henry Ford

# Pasqyra e Lëndës


Pasqyra e Lëndës 2

Parime Udhëzuese 4

Kalimi në Afatet Kohore Hibride 5

Përzgjedhja e Modelit 5

Vendndodhje Zonash për Nxënës/e që Kalojnë në Hibrid 15 Mars, 2021 8

Modele Mësimdhënieje 9

Përzgjedhja e Grupit 10

Shembuj Oraresh Shkollorë 11

Siguria e Nxënësve/eve & Stafit 18

Përshtatja e Klasës 19

Pajisjet e Shkollës 19

Tranzicioni i Nxënësve/eve 20

Ardhja 21

Largimi 21

Mëngjesi dhe Dreka 22

Pushimi 22

Pushimet për Maskat 23

Larja e Duarve 23

Procedurat e Përdorimit të Banjës 24

Protokolle të Shkollës & të Sistemit të Gjerë të Stafit 24

Lejimi i Vizitorëve/eve në Ndërtesë 25

Cilësia e Ajrit dhe Protokolli i Pastrimit 25

Transporti 27

Shërbimi i Ushqimit për Familjet 27

Dhoma Mjekësore e Pritjes & Zyra e Infermierit/es për Covid-19 28

Nxënës/e dhe Staf që Shfaqin Simptoma 29

Protokolle për Mbyllje të Mundshme të Shkollës 29

Kontakte të Distriktit 30

Burime 30






We are
the
future

# Parime Udhëzuese

**Mjedis i Shëndetshëm Edukues**

Ne do të sigurojmë që masat e duhura për të mbrojtur sigurinë dhe shëndetin e nxënësve/eve dhe stafit tonë të jenë një përparësi kryesore duke:

- siguruar ndërtesa të pastra dhe të dezinfektuara
- investuar në pajisje për të siguruar përmirësime dhe siguri të cilësisë së ajrit
- i dhënë prioritet trajnimit të stafit dhe nxënësve/eve mbi format e zbutjes së COVID-19, po ashtu edhe rutina e shkollës është përshtatur për të minimizuar rrezikun

**Mundësi të Qëndrueshme Udhëzuese**

Ne do të mundësojmë udhëzime me cilësi të lartë sinkron, asinkron dhe hibride, për nxënësit/et gjatë kohës së mësimit në distancë dhe atij hibrid duke:

- u mundësuar nxënësve/eve të kenë qasje në pajisjet dhe internetin e distriktit
- modifikuar programet kurrikulare për të mbështetur modele të shumta të të mësuarit
- ofruar në mënyrë të vazhdueshme teknologji udhëzuese profesionale, të zhvilluar, integruese
- siguruar platforma moderne të të mësuarit, bazuar në kërkime

**Mbështetje Social-Emocionale për Nxënësit/et**

Ne jemi të vetëdijshëm për ndikimin e pandemisë tek nxënësit/et dhe po i japim përparësi mirëqenies së tyre përmes:

- sondazheve çdo dy javë për nxënësit/et SEL dhe vlerësimit të nevojave të tyre akademike
- mbështetjes së specializuar dhe të individualizuar SEL
- orareve të strukturuara, me kohë për regjistrime dhe mbështetje të grupeve të vogla

**Mundësi të Barabarta të të Mësuarit për Nxënësit/et**

Ne do të sigurojmë mësim me cilësi të lartë për të gjithë nxënësit/et përmes:

- sigurimit që Nxënësit/et me Aftësi Ndryshe të marrin mbështetjen dhe udhëzimet e duhura
- sigurimit që Nxënësit/et e Gjuhës Angleze të marrin mbështetjen dhe udhëzimet e duhura
- zbatimit të vazhdueshëm të praktikave kulturore të përgjegjshme, të përqendruara tek nxënësi/ja në të gjitha orët e mësimit
- sigurimit të akomodimeve të ndryshme, në mënyrë që mësimi të mundësohet lehtësisht për të gjithë nxënësit/et

**Komunikim Transparent**

Ne jemi të përkushtuar të sigurojmë informacion në kohë për familjet dhe anëtarët/et e komunitetit, në lidhje me ndërrimet dhe ndryshimet që lidhen me procedurat shkollore të COVID-19 përmes:

- përditësimeve të shpeshta të faqes në internet, me informacion të përkthyer
- përdorimit të mënyrave të shumta për të komunikuar me familjet, përfshirë forumet e komunitetit, mesazhet ConnectEd, mesazhet me tekst, thirrjet telefonike, mediat sociale dhe përditësimet e faqeve të internetit

> *WPS është duke punuar në mënyrë të ngushtë me Projektin Parabola, për të ofruar udhëzime, mjete dhe strategji për të kuptuar dhe minimizuar rreziqet, ndërkohë që maksimizon të mësuarin dhe mirëqenien gjatë COVID-19.*
>
> *-Projekti Parabola*

## Kalimi në Afatet Kohore Hibride

**15/09/20 - 12/03/21**
Të gjithë Nxënësit/et në Distancë

→

**15/03/21**
Nxënësit/et me Aftësi Ndryshe Komplekse dhe Nxënësit/et SLIFE NCC

→

**29/03/21**
Gjithë të tjerët/at PreK -12

## Përzgjedhja e Modelit (Data nga 12/02/21)

### Sipas Nivelit

| Përmbledhje 12-02-21 | Nxënës/e Total | Asnjë Përgjigje | Asnjë Përgjigje % | Distancë | Distancë % | Hibrid | Hibrid % |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Fillore | 13,072 | 552 | 4% | 5,520 | 42% | 7,000 | 54% |
| Tetëvjeçare | 3,239 | 95 | 3% | 1,465 | 45% | 1,679 | 52% |
| Shkollë e Mesme | 7,147 | 76 | 1% | 3,410 | 48% | 3,661 | 51% |
| Programe Alternativë | 585 | 44 | 8% | 214 | 37% | 327 | 56% |
| **Totali** | **24,043** | **767** | **3%** | **10,609** | **44%** | **12,667** | **53%** |

*vetëm në Zonën e Shkollës

## Sipas Shkollës

| | Numri i Nxënësve/eve | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Zona** | **Totali** | **Hibrid** | **Distancë** | **Asnjë Përgjigje** |
| Burncoat High | 1110 | 504 | 587 | 19 |
| Claremont Academy | 511 | 187 | 320 | 4 |
| Doherty High | 1327 | 729 | 598 | |
| North High | 1185 | 600 | 582 | 3 |
| South High | 1320 | 608 | 702 | 10 |
| Technical High | 1465 | 925 | 511 | 29 |
| University Park | 229 | 108 | 110 | 11 |
| Burncoat Middle | 677 | 383 | 288 | 6 |
| Forest Grove | 905 | 542 | 348 | 15 |
| Sullivan Middle | 922 | 422 | 474 | 26 |
| Worc East Middle | 735 | 332 | 355 | 48 |
| Belmont Community | 538 | 273 | 264 | 1 |
| Burncoat Elementary | 257 | 141 | 106 | 10 |
| Canterbury Street | 296 | 180 | 116 | |
| Chandler Elementary | 446 | 202 | 241 | -3 |
| Chandler Magnet | 483 | 220 | 258 | 5 |
| City View | 465 | 234 | 231 | |
| Clark Street | 233 | 126 | 105 | 2 |
| Columbus Park | 370 | 216 | 145 | 9 |
| Elm Park Community | 401 | 225 | 173 | 3 |
| Flagg Street | 339 | 235 | 103 | 1 |
| Gates Lane | 520 | 298 | 221 | 1 |
| Goddard | 363 | 144 | 218 | 1 |
| Grafton Street | 378 | 174 | 197 | 7 |
| Head Start | 336 | 4 | 10 | 322 |
| Heard Street | 245 | 161 | 84 | |
| Jacob Hiatt | 382 | 201 | 181 | |
| Lake View | 311 | 203 | 108 | |
| Lincoln Street | 245 | 126 | 114 | 5 |
| May Street | 279 | 182 | 96 | 1 |

| Zona | Totali | Hibrid | Distancë | Asnjë Përgjigje |
|---|---|---|---|---|
| Mcgrath | 226 | 111 | 114 | 1 |
| Midland Street | 202 | 117 | 85 | |
| Nelson Place | 541 | 385 | 153 | 3 |
| Norrback Avenue | 524 | 281 | 176 | 67 |
| Quinsigamond | 688 | 348 | 339 | 1 |
| Rice Square | 467 | 228 | 179 | 60 |
| Roosevelt | 609 | 376 | 228 | 5 |
| Tatnuck Magnet | 393 | 257 | 136 | |
| Thorndyke Road | 352 | 189 | 159 | 4 |
| Union Hill | 387 | 171 | 206 | 10 |
| Vernon Hill | 477 | 252 | 218 | 7 |
| Wawecus Road | 125 | 71 | 54 | |
| West Tatnuck | 332 | 213 | 101 | 18 |
| Woodland Academy | 505 | 208 | 292 | 5 |
| Worc Arts Mag | 357 | 248 | 109 | |
| Acad Ctr Trans ASP | 6 | 5 | 1 | |
| Assessment - McKeon | 4 | | 1 | 3 |
| Dept Youth Services | 6 | 2 | 3 | 1 |
| Goddard ASP | 9 | 8 | 1 | |
| Harlow ASP | 3 | 1 | 2 | |
| Recovery High School | 1 | | | 1 |
| Transition 45 Day | 1 | | | 1 |
| Woodward Day 2 | 15 | 1 | 3 | 11 |
| Woodward Day 3 | 2 | | | 2 |
| Academic Ctr Trans | 42 | 22 | 20 | |
| Alt St Casimir | 41 | 21 | 13 | 7 |
| Challenge Academy | 13 | 11 | 2 | |
| Evening High School | 77 | 17 | 58 | 2 |
| G Creamer Ctr | 147 | 82 | 61 | 4 |
| Gateway to College | 1 | 1 | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Home Hospital | 2 | 2 | | |
| NCC Elementary | 15 | 15 | | |
| **Zona** | **Totali** | **Hibrid** | **Distancë** | **Asnjë Përgjigje** |
| NCC Secondary | 46 | 40 | 6 | |
| NCC Young Adult | 20 | 17 | 2 | 1 |
| PreK at SHS | 13 | 8 | 2 | 3 |
| PreK at WTHS | 23 | 17 | 5 | 1 |
| Reach Academy | 32 | 31 | 1 | |
| Returnee Program | 13 | 2 | 4 | 7 |
| SpEd Transition | 53 | 24 | 29 | |
| ***Totali*** | **24,043** | **12,667 53%** | **10,609 44%** | **767 3%** |

## Vendndodhje Zonash për Nxënës/e që Kalojnë në Hibrid 15 Mars, 2021

*Përfshirë, nga secila shkollë, është numri total i nxënësve/eve (H-#hibrid, D-#Distancë, AP-#Asnjë Përgjigje), numri dhe lloji i klasës, shkolla nis & koha e mbylljes.*

- **Programe Alternative @ St. Casmirs**
  - Programe Alternative @ St. Casmirs (35 Total, 21H, 10D, 4AP) 7:30-13:11
- **Burncoat High School**
  - Burncoat High (86 Total, 45H, 41D) (5-COAST, 1-LS, 3-STEP) 7:20-13:43
- **Burncoat Middle School**
  - Burncoat Middle (26 Total,12H, 14D) (2-COAST, 4-STEP & Burime) 7:20-13:43
- **Burncoat Prep**
  - Burncoat Prep (15 Total, 5H, 10D) (2-STEP) 8:05-14:10
- **Canterbury Street School**
  - Canterbury (15 Total, 10H, 5D) (2-TLS) 7:45-13:50
- **Central Mass Collaborative -** New Bond Street
  - Program ACT (42 Total, 29H, 17D) 8:30-14:30
- **Chandler Elementary**
  - Chandler Elementary (14 Total 13H, 1D) (2-STEP) 7:50-13:55
- **City View Discovery School**
  - City View (31 Total, 21H, 10D) (2-K/1 & 2-STEP ) 9:05-15:10
- **Clark Street**
  - NCC Elementary (15 Total, 15H) (SLIFE) 8:25-14:30
- **Columbus Park School**
  - Columbus Park (19 Total, 16H, 3D) (2-STEP) 7:45-13:50
- **Doherty High School**
  - Doherty (30 total, 16H, 14D) (1-LS, 3-STEP) 7:20-13:43
- **Fanning Building**
  - Të Rritur të Rinj NCC (20 Total, 17H, 2D, 1AP) (SLIFE) 7:20-13:43
  - Programe Tranzicioni (56 Total, 28H, 28D) 8:00-14:00
- **Forest Grove Middle School**
  - Forest Grove (47 total, 35H, 15D) (2-LS, 2-TLS, 2-STEP) 8:47-15:10

- **Gates Lane**
    - Gates Lane (89 Total, 64H, 25D) (1/pk sub-sep & 9-AU/SAIL) 9:05-15:10
- **Lincoln Street**
    - Lincoln Street (7 Total, 6H, 1D) ( 1-AU/SAIL) 7:45-13:50
- **Nelson Place School**
    - Chandler Magnet (2 Total, 1H, 1D) (PreK)
    - Nelson Place (102 Total, 73H, 28D, 1AP) (10-SAIL) (1 PK sub/sep) (1 Zëra të Rinj (Young Voices)) 9:05-3:10
- **Qendra e Qytetarëve/eve të Rinj/Reja (New Citizen's Center)@New Ludlow**
    - NCC Secondary (46 Total, 40H, 6D) (SLIFE) 8:00-14:15
- **Norrback Avenue School**
    - Norrback (69 Total, 43H, 26D) (3- AU/SAIL & 2-LS) 7:55-14:00
- **North High School**
    - North High (67 Total, 31H, 36D) (1-AULS,3-LS, 3-STEP) 7:20-13:43
- **Quinsigamond Elementary School**
    - Quinsigamond (36 Total, 21H, 14D, 1AP) (2-LS & 2-STEP) 8:25-14:30
- **Roosevelt Elementary**
    - Roosevelt Elementary (56 Total, 28H, 26D, 2AP) (1-PK sub-sep, 2-K/1, 2-STEP, 3-LS,) 8:15-14:20
- **South High Community School**
    - South High (72 Total, 33H, 39D) (1-AU/LS, 3-LS, 4-STEP) 7:20-13:43
- **Sullivan Middle School**
    - Sullivan (58 Total, 28H, 30D) (2-AULS, 2-TLS, 1-LS, 2-STEP) 8:47-15:10
- **Vernon Hill**
    - Vernon Hill School (13 Total, 8H, 5D) (2-STEP) 7:45-13:50
- **Wawecus Road School**
    - Wawecus (23 Total, 14H, 9D) (3-TLS) 8:25-14:30
- **West Tatnuck School**
    - West Tatnuck School (13 Total, 7H, 6D)(2-LS) 9:05-15:10
- **Worcester East Middle School**
    - WEMS (13 Total, 6H, 7D) (2-STEP & 4- Resource) 7:20-13:43
- **Worcester Technical High School**
    - WTHS (41 Total, 26H, 13D, 2AP) (4-Voc-P) 7:20-13:43

# Modele Mësimdhënieje

Duke pasur parasysh burimet aktuale, do të zbatohen dy mundësi modelesh të mësuari:

- Mundësia 1 - Personalisht/Distancë Hibrid
- Mundësia 2 - Personalisht/Modeli në Distancë

**Mundësia 1 - Personalisht/Distancë Hibrid**

Në këtë model klase mësuesit/et do të klasifikohen në dy grupe, mësues/e për mësim Hibrid dhe mësues/e për mësim në Distancë.

- Mësuesit/et e klasave hibride do të japin mësim për nxënësit/et që kanë përzgjedhur të mësuarin hibrid. Mësuesit/et e klasave hibride do japin mësim për nxënës/e që kanë zgjedhur hibridin, ndërkohë që ata/ato po mësojnë si personalisht, ashtu edhe në distancë
- Mësuesit e klasave në Distancë do të japin mësim për nxënësit/et që kanë përzgjedhur të mësuarin në distancë 100%
- Kjo mundësi mund të jetë e bazuar në nivel ndërtese, departamenti dhe/ose klase

**Mundësia 2 - Personalisht/Modeli në Distancë** *(mundësia më e përdorur)*
Në këtë model klase mësuesit/et do u japin mësim nxënësve/eve, që kanë përzgjedhur të mësuarin hibrid dhe 100% të mësuar në distancë. Për të lehtësuar mësimdhënien:

- Mësuesit/et do të japin udhëzime ditore për të gjithë nxënësit/et
- Të gjithë nxënësit/et do të fillojnë ditën/secilën klasë në të njëjtën kohë, në mësimdhënie sinkron, me mësuesin/en e tyre
- Si nxënësit/et hibrid, ashtu edhe ata në distancë, do të marrin pjesë në kohë të njëjtë në mësimdhënien sinkron me mësuesit/et e tyre çdo ditë, sa herë të jetë e përshtatshme. Do të mundësohen punë dhe projekte të pavarura, të përqendruara në të mësuarin, duke kufizuar kohën para ekranit, mësimdhënie e diferencuar dhe duke mundësuar kohë për nxënësit/et të eksplorojnë dhe krijojnë
- Kur është e nevojshme, do të mundësohet kohë gjatë ditës së shkollës, për t'u dhënë mundësinë mësuesve/eve për t'u takuar çdo ditë me nxënës/e në distancë

# Përzgjedhja e Grupit

Për të zvogëluar numrin e nxënësve/eve në kamp, në çdo kohë, ata/ato do të ndahen në grupe. Si rrjedhojë e numrit aktual të familjeve, që kanë zgjedhur mësimin në distancë, distrikti do të jetë në gjendje të akomodojë nxënësit/et për të ndjekur shkollën personalisht dy ditë në javë. Kjo do të thotë që do të jenë dy grupe nxënësish/esh, me Grupin 1 që do të ndjekë shkollën personalisht të hënën dhe të martën dhe Grupin 2, që do të ndjekë shkollën personalisht të mërkurën dhe të enjten.

Drejtorët dhe drejtoreshat do të jenë përgjegjës/e për ndarjen e nxënësve/eve në grupe. Për shkak të kompleksitetit të orareve të nxënësve/eve të shkollave të mesme (Kapitulli 74, Rrugët e Rinovimit, Regjistrimi i Dyfishtë, Programimi i Vendosjes së Avancuar), shkollave të mesme do t'u ofrohet mundësia e parë në zgjedhjen e grupeve për nxënësit/et me vëllezër dhe motra në klasat më poshtë. Kritere të tjera që do të merren në konsideratë, kur të ndahen nxënësit/et në grupe janë numri i personave në autobus dhe itinerari, si edhe konsideratat e vështirësive nga prindërit.

# Shembuj Oraresh Shkollorë

**Shembull 2.45 Orari i Ditës – Mëngjesi Ballë për Ballë**

<table>
<tr><th></th><th>E Hënë</th><th>E Martë</th><th>E Mërkurë</th><th>E Enjte</th><th>E Premte</th></tr>
<tr><td>9:05-9:30</td><td colspan="4">Mbërritja/Larja e Duarve/Pak Lojëra</td><td rowspan="7">Dita e Mësimit në Distancë<br><br>Check-in, Gjithë Grupi, Grup i Vogël, Të Mësuarit Sinkron, Asinkron (Seesaw)</td></tr>
<tr><td>9:30-9:45</td><td colspan="4">Larja e Duarve / Mëngjesi</td></tr>
<tr><td>9:40-10:10</td><td colspan="4">Koha e Rrethit/ Gjithë Grupi / Lexim me Zë të Lartë Interaktiv</td></tr>
<tr><td>10:10-10:30</td><td colspan="4">Pushim</td></tr>
<tr><td>10:30-11:20</td><td colspan="4">Larja e Duarve /Koha e Qendrës (grupe të vogla)</td></tr>
<tr><td>11:05-11:35</td><td colspan="4">Kënga e Lëvizjes/ Lexim me Zë të Lartë</td></tr>
<tr><td>11:35-11:50</td><td colspan="4">Paketimi i Sendeve/Përfundimi / Koha për Ipad</td></tr>
</table>

**Shmebull 2.45 Orari i Ditës – Pasditja në Distancë**

| | E Hënë | E Martë | E Mërkurë | E Enjte | E Premte |
|---|---|---|---|---|---|
| 11:50-12:30 | Përgatitja dhe Dreka për Stafin | | | | Dita e Mësimit në Distancë<br><br>Check-in, Gjithë Grupi, Grup i Vogël, Të Mësuarit Sinkron, Asinkron (Seesaw) |
| 12:30-1:00 | I Gjithë Grupi në Takimin Google Meet<br>Takimi i Mëngjesit<br>(përshëndetja, kalendari, identifikimi i emrit, shkronja/ # koha) | | | | |
| 1:30-1:50 | Aktiviteti Seesaw në ELA / Leximi Interaktiv me Zë | | | | |
| 1:50-2:05 | Kënga e Lëvizjes me të Gjithë Grupin në Google Meet | | | | |
| 2:05-2:15 | Pushim | | | | |
| 2:15-2:45 | Google Meet në Grupe të Vogla me Mësuesin/en dhe IA-të | | | | |
| 2:45-3:15 | Aktiviteti Seesaw në Matematikë | | | | |
| 2:45-3:15 | Orari për Pyetje ndaj Mësuesit/es / Takime 1:1 me Nxënësit nëse do jetë e Nevojshme | | | | |

## *Shembull* Orar për Nxënës/e të Shkollës Fillore

| Ora | E hënë | E martë | E mërkurë | E enjte | E premte |
|---|---|---|---|---|---|
| 8:30 - 10:00 | **Blloku 1: ELA** Personalisht & Sinkron në distancë | **Blloku 1: ELA** Personalisht & Sinkron në distancë | **Blloku 1: ELA** Personalisht & Sinkron në distancë | **Blloku 1: ELA** Personalisht & Sinkron në distancë | **Blloku 1** Mësime Sinkron |
| 10:00-10:15 | Pushim | Pushim | Pushim | Pushim | |
| 10:15 - 11:45 | **Blloku 2: Matematikë** Personalisht & Sinkron në distancë | **Blloku 2: Matematikë** Personalisht & Sinkron në distancë | **Blloku 2: Matematikë** Personalisht & Sinkron në distancë | **Blloku 2: Matematikë** Personalisht & Sinkron në distancë | |
| 11:45 - 12:30 | Drekë/Pushim | Drekë/Pushim | Drekë/Pushim | Drekë/Pushim | Kontrolle në të Mësuarin Asinkron<br>Punë me Projekte<br>Kontrolle të targetuara<br>Udhëtime Virtuale në Terren<br>Klasa me Institucione Kulturore |
| 12:30 - 1:15 | **Blloku 3** Personalisht & sinkron në distancë Special (Art): | **Blloku 3** Personalisht & sinkron në distancë Special (PE) | **Blloku 3** Personalisht & sinkron në distancë Special (Tekn) | **Blloku 3** Personalisht & sinkron në distancë Special (Muzikë) | |
| 1:15 - 2:00 | **Blloku 4** Personalisht & Studime Sociale Sinkron – Mësime Shkence | **Blloku 4** Personalisht & Studime Sociale Sinkron – Mësime Shkence | **Blloku 4** Personalisht & Studime Sociale Sinkron – Mësime Shkence | **Blloku 4** Personalisht & Studime Sociale Sinkron – Mësime Shkence | |
| 2:00 - 2:30 | **Personalisht & Sinkron** Kontrolle/reflektime Përfundimi i rutinës së ditës | **Personalisht & Sinkron** Kontrolle/reflektime Përfundimi i rutinës së ditës | **Personalisht & Sinkron** Kontrolle/reflektime Përfundimi i rutinës së ditës | **Personalisht & Sinkron** Kontrolle/reflektime Përfundimi i rutinës së ditës | |

## *Shembull* Orar për Nxënës/e të Shkollës Tetëvjeçare – CIKËL DY-JAVORSH (A)

| Ora | Blloku | E hënë | E martë | E mërkurë | E enjte | E premte |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **8:47 –9:02 (15 min)** | | Dhoma në shtëpi | Dhoma në shtëpi | Dhoma në shtëpi | Dhoma në shtëpi | Dhoma në shtëpi |
| **9:02 – 10:08 (66 min)** | 1 | Periudha 1 | Periudha 2 | Periudha 1 | Periudha 2 | **PERIUDHA 2** |
| **10:08 – 10:18 (10 min)** | | Koha e Tranzicionit | Koha e Tranzicionit | Koha e Tranzicionit | Koha e Tranzicionit | Koha e Tranzicionit |
| **10:18 – 11:24 (66 min)** | 2 | Periudha 3 | Periudha 4 – 5<br>Periudha 5 – 6 | Periudha 3 | Periudha 4 – 5<br>Periudha 5 – 6 | **PERIUDHA 4-5**<br>**PERIUDHA 5-6** |
| **11:24 –12:17 (53 min)** | | Studime të Pavarura | Studime të Pavarura | Studime të Pavarura | Studime të Pavarura | Studime të Pavarura |
| **12:17 – 12:47 (30 min)** | | Dreka | Dreka | Dreka | Dreka | Dreka |
| **12:47 – 1:53 (66 min)** | 3 | Periudha 6 – 7<br>Periudha 7 – 8 | Periudha 9 | Periudha 6 – 7<br>Periudha 7 – 8 | Periudha 9 | Punë në Klasa të Pavarura/Projekte/Udhëtime Virtuale në Terren |
| **1:53 – 2:03 (10 min)** | | Koha e Tranzicionit | Koha e Tranzicionit | Koha e Tranzicionit | Koha e Tranzicionit | |
| **2:03 – 3:09 (66 min)** | 4 | Periudha 10 | **PERIUDHA 1** | Periudha 10 | **PERIUDHA 3** | |
| **3:09 – 3:42 (33 min)** | | | Sesione për Ndihmë Shtesë | Sesione për Ndihmë Shtesë | Sesione për Ndihmë Shtesë | |

## *Shembull* Orar për Nxënës/e të Shkollës Tetëvjeçare – CIKËL DY-JAVORSH (B)

| Ora | Blloku | E hënë | E martë | E mërkurë | E enjte | E premte |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **8:47 –9:02 (15 min)** | | Dhoma në shtëpi | Dhoma në shtëpi | Dhoma në shtëpi | Dhoma në shtëpi | Dhoma në shtëpi |
| **9:02 – 10:08 (66 min)** | 1 | Periudha 1 | Periudha 2 | Periudha 1 | Periudha 2 | **PERIUDHA 9** |
| **10:08 – 10:18 (10 min)** | | Koha e Tranzicionit | Koha e Tranzicionit | Koha e Tranzicionit | Koha e Tranzicionit | Studim i Pavarur ***10:08-12:17 (129 min)*** |
| **10:18 – 11:24 (66 min)** | 2 | Periudha 3 | Periudha 4 – 5<br>Periudha 5 – 6 | Periudha 3 | Periudha 4 – 5<br>Periudha 5 – 6 | |
| **11:24 –12:17 (53 min)** | | Studim i Pavarur | Studim i Pavarur | Studim i Pavarur | Studim i Pavarur | |
| **12:17 – 12:47 (30 min)** | | Dreka | Dreka | Dreka | Dreka | Dreka |
| **12:47 – 1:53 (66 min)** | 3 | Periudha 6 – 7<br>Periudha 7 – 8 | Periudha 9 | Periudha 6 – 7<br>Periudha 7 – 8 | Periudha 9 | Punë e Pavarur në Klasë/Projekte/Udhët ime Virtuale në Terren |
| **1:53 – 2:03 (10 min)** | | Koha e Tranzicionit | Koha e Tranzicionit | Koha e Tranzicionit | Koha e Tranzicionit | |
| **2:03 – 3:09 (66 min)** | 4 | Periudha 10 | **PERIUDHA 6-7**<br>**PERIUDHA 7-8** | Periudha 10 | **PERIUDHA 10** | |
| **3:09 – 3:42 (33 min)** | | | Sesione me Ndihmë Shtesë | Sesione me Ndihmë Shtesë | Sesione me Ndihmë Shtesë | |

## *Shembull* Orar për Nxënës/e të Shkollës së Mesme – CIKËL DY-JAVORSH (A)

| Ora | Blloku | E hënë | E martë | E mërkurë | E enjte | E premte |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **7:20 - 8:30 (70 min)** | 1 | Periudha 1 | **PERIUDHA 1** | Periudha 1 | **PERIUDHA 2** | **PERIUDHA 4-5**<br>**PERIUDHA 5-6** |
| **8:30 - 8:40 (10 min)** | | Tranzicion/Përgatitja e Klasës | Tranzicion/Përgatitja e Klasës | Tranzicion/Përgatitja e Klasës | Tranzicion/Përgatitja e Klasës | Tranzicion/Përgatitja e Klasës |
| **8:40- 9:50 (70 min)** | 2 | Periudha 2 | Periudha 4 – 5<br>Periudha 5 – 6 | Periudha 2 | Periudha 4 – 5<br>Periudha 5 – 6 | **PERIUDHA 6-7**<br>**PERIUDHA 7-8** |
| **9:50 - 10:43 (53 min)** | | Punë e Pavarur në Klasë | Punë e Pavarur në Klasë | Punë e Pavarur në Klasë | Punë e Pavarur në Klasë | Punë e Pavarur në Klasë |
| **10:43 - 11:13 (30 min)** | | Dreka | Dreka | Dreka | Dreka | Dreka |
| **11:13 - 12:23 (70 min)** | 3 | Periudha 3 | Periudha 6 – 7<br>Periudha 7 – 8 | Periudha 3 | Periudha 6 – 7<br>Periudha 7 – 8 | Punë e Pavarur në Klasë/Projekte/ Udhëtime Virtuale në Terren |
| **12:23 - 12:33 (10 min)** | | Tranzicion/Përgatitja e Klasës | Tranzicion/Përgatitja e Klasës | Tranzicion/Përgatitja e Klasës | Tranzicion/Përgatitja e Klasës | |
| **12:33 - 1:43 (70 min)** | 4 | Periudha 9 | Periudha 10 | Periudha 9 | Periudha 10 | |
| **2:00 -2:40 (40 min)** | | | Sesione me Ndihmë Shtesë | Sesione me Ndihmë Shtesë | Sesione me Ndihmë Shtesë | |

## *Shembull* Orar për Nxënës/e të Shkollës së Mesme – CIKËL DY-JAVORSH (Java B)

| Ora | Blloku | E hënë | E martë | E mërkurë | E enjte | E premte |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **7:20 - 8:30 (70 min)** | 1 | Periudha 1 | **PERIUDHA 3** | Periudha 1 | **PERIUDHA 9** | **PERIUDHA 10** |
| **8:30 - 8:40 (10 min)** | | Tranzicion/Përgatitja e Klasës | Tranzicion/Përgatitja e Klasës | Tranzicion/Përgatitja e Klasës | Tranzicion/Përgatitja e Klasës | Punë e Pavarur në Klasë ***8:30 – 10:43*** |
| **8:40- 9:50 (70 min)** | 2 | Periudha 2 | Periudha 4 – 5<br>Periudha 5 – 6 | Periudha 2 | Periudha 4 – 5<br>Periudha 5 – 6 | |
| **9:50 - 10:43 (53 min)** | | Punë e Pavarur në Klasë | Punë e Pavarur në Klasë | Punë e Pavarur në Klasë | Punë e Pavarur në Klasë | |
| **10:43 - 11:13 (30 min)** | | Dreka | Dreka | Dreka | Dreka | Dreka |
| **11:13 - 12:23 (70 min)** | 3 | Periudha 3 | Periudha 6 – 7<br>Periudha 7 – 8 | Periudha 3 | Periudha 6 – 7<br>Periudha 7 – 8 | Punë e Pavarur në Klasë/Projekte/ Udhëtime Virtuale në Terren |
| **12:23 - 12:33 (10 min)** | | Tranzicion/Përgatitja e Klasës | Tranzicion/Përgatitja e Klasës | Tranzicion/Përgatitja e Klasës | Tranzicion/Përgatitja e Klasës | |
| **12:33 - 1:43 (70 min)** | 4 | Periudha 9 | Periudha 10 | Periudha 9 | Periudha 10 | |
| **2:00 -2:40 (40 min)** | | | Sesione me Ndihmë Shtesë | Sesione me Ndihmë Shtesë | Sesione me Ndihmë Shtesë | |

## Siguria e Nxënësve/eve & Stafit

**Udhëzime të Distriktit**

- Stafi do të marrë trajnim gjithëpërfshirës për sigurinë, duke përfshirë edhe materiale në video për hapjen e sigurt të shkollës, në katër pjesë
- Nxënësve/eve u kërkohet të marrin me vete dy maska në shkollë, çdo ditë
- Maskat dhe dorezat do të jenë në dispozicion, sipas kërkesave, për të gjithë stafin dhe nxënësit/et
- Maskat janë të detyruara të mbahen gjatë gjithë kohës, përveç gjatë kohës së pushimit të mbajtjes se maskave
- Do të respektohet rregulli i distancimit social prej dy metrash
- Numri i personave brenda një zone të mbyllur do të jetë i kufizuar, për të ulur ekspozimin ndaj Covid-19
- Do të krijohen plane tranzicioni dhe drejtimi, për lëvizjet e sigurta në të gjithë ndërtesën
- Nxënësit/et dhe stafi do të trajnohen për larjen e duarve
- Do të vendosen oraret e larjes së duarve
- Dezinfektantët e duarve do të vendosen në çdo klasë dhe në vendet e tjera kryesore, në të gjitha shkollat
- PPE shtesë dhe mjete pastrimi do të jenë në dispozicion në shkollat tona, duke përfshirë peceta dezinfektuese, maska, mburoja, doreza, dezinfektantë duarsh dhe veshje të tjera për të gjitha nevojat



# Përshtatja e Klasës

**Udhëzime të Distriktit**

- Tavolinat dhe bangat do të vendosen në dy metra distancë dhe në të njëjtin drejtim
- Mobiliet e papërdorura mund të hiqen për të mundësuar më shumë hapësirë
- Nxënësit/et do të përdorin të njëjtat karrige, të përcaktuara më parë, për të lehtësuar gjurmimin nëse do të jetë e nevojshme
- Do të postohet sinjalistika e protokolleve



# Pajisjet e Shkollës

**Udhëzime të Distriktit**

- Secili nxënës/e do të ketë pajisjet e veta shkollore
- Sendet personale do të ndahen veçmas dhe nuk do të përdoren me të tjerët
- Për pajisjet që duhet të përdoren nga të gjithë do të ketë një protokoll pastrimi për dezinfektimin nga një përdorim te tjetri

- Dollapët nuk do të përdoren gjatë kësaj faze rihapjeje; palltot dhe çantat e shpinës do të lejohen në klasa
- Nxënësve/eve do u kërkohet të sjellin karrikuesit e tyre, kufjet dhe pajisjet e përcaktuara nga distrikti, që do të jenë me bateri të karrikuara plotësisht në shkollë çdo ditë
- Nxënësit/et nuk duhet të sjellin 'hotspot'-et e tyre në shkollë
- Nxënësit/et nuk do të jenë në gjendje të përdorin një pajisje personale në shkollë



## Tranzicioni i Nxënësve/eve

**Udhëzime të Distriktit**

- Sinjalistika do të afishohen në të gjithë ndërtesën për të drejtuar tranzicionin e nxënësve/eve dhe për të respektuar distancën prej 2 metrash
- Korridoret dhe shkallët do të përcaktohen si pika dalëse dhe/ose hyrëse, për të shmangur nxënësit/et të ndeshen me njëri-tjetrin, ballë për ballë dhe shmangur grumbullimin
- Kur nxënësit/et të lëvizin, stafi do të monitorojë procesin për të siguruar respektimin e distancës prej dy metrash



# Ardhja

**Udhëzime të Distriktit**

- Të gjithë nxënësit/et/familjet duhet të kryejnë vetë një kontroll të simptomave përmes portalit shëndetësor, çdo ditë para se të nisen për në shkollë
- Arritja do të ketë orare të shkallëzuara, për të shmangur grupet e mëdha që hyjnë në ndërtesë në të njëjtën kohë
- Distancimi social do të ruhet gjatë hyrjes në ndërtesë me monitorimin e stafit
- Nxënësit/et do të shkojnë drejtpërdrejt në klasa pasi hyjnë në ndërtesë




# Largimi

**Udhëzime të Distriktit**

- Stafi dhe nxënësit/et duhet të respektojnë distancën sociale, kur përgatiten për largimin nga shkolla
- Koha e largimit do të jetë po ashtu e shkallëzuar, për të shmangur daljen e grupeve të mëdha nga ndërtesa
- Nxënësit/et dhe stafi duhet të mbajnë maska gjatë gjithë procesit të largimit nga shkolla
- Nxënësit/et që ecin për në shtëpi duhet të ruajnë distancën sociale dhe të mbajnë maska



# Mëngjesi dhe Dreka

**Udhëzime të Distriktit**

- Të gjitha çezmat e ujit do të mbyllen
- Shërbimi i ushqimit do të sigurojë ujë gjatë ditës së shkollës
- Fëmijët do të marrin Mëngjesin dhe Drekën dhe do të largohen, ose do të shpërndahet në klasë
- Mëngjesi dhe Dreka do të konsumohen në klasa ose në kafenenë e shkollës
- Nxënësit/et do të ruajnë distancën prej dy metrash gjatë ngrënies




# Pushimi

**Udhëzime të Distriktit**

- Të gjitha shkollat fillore do të kenë pushime të planifikuara
- Nxënësit/et do të lajnë duart pas pushimit
- Nxënësve/eve do t'u kërkohet të mbajnë maskat dhe të ruajnë distancën sociale ndërkohë që luajnë
- Terrenet e lojërave do të qëndrojnë të mbyllura gjatë muajve të dimrit
- Nxënësit/et mund të bëjnë pushime maskash gjatë pushimeve duke ruajtur distancën sociale



## Pushimet për Maskat

**Udhëzime të Distriktit**

- Do të ketë pushime të planifikuara që nxënësit/et të mund të heqin maskat
- Pushimet do të bazohen në moshën dhe nevojat e tyre
- Pushimet e maskave do të bëhen jashtë, kur është e mundur
- Gjatë këtij pushimi, nxënësi/ja do të jetë në një zonë të caktuar, duke ruajtur distancën



## Larja e Duarve

**Udhëzime të Distriktit**

- Nxënësve/eve dhe stafit do t'u kërkohet të lajnë duart shpesh
- Rekomandimi është larja e duarve me sapun dhe ujë të ngrohtë për 20 sekonda
- Dezinfektanti i duarve do të jetë në dispozicion në çdo shkollë




# Procedurat e Përdorimit të Banjës

**Udhëzime të Distriktit**

- Protokollet e sigurisë do të vendosen në shkolla, bazuar në vendndodhjen dhe kapacitetin e banjës
- Pushimet për në banjë do të kryhen njësoj si gjatë orëve normale të shkollës
- Nxënësit/et që presin për të përdorur banjën do të jenë larg njëri-tjetrit dhe do të mbajnë maska
- Do të postohen sinjalistika për t'u kujtuar nxënësve/eve të lajnë duart
- Mbajtëset e sapunit do të mbushen rregullisht



# Protokolle të Shkollës & të Sistemit të Gjerë të Stafit

**Udhëzime të Distriktit**

- Të gjithë anëtarët/et e stafit, si të bazuar në shkollë, ashtu edhe të sistemit të gjerë do të kërkohet të identifikohen në një zonë të caktuar
- Kur të vizitohen ndërtesat e shkollës, maska do të mbahet nga i gjithë stafi dhe do të respektohet distanca sociale
- Hapësirat e punës në ndërtesë mund të përdoren për udhëzime të specializuara
- Hapësirat e punës që lejojnë grumbullime do të ndalohen (siç janë dhomat e mësuesve/eve për të konsumuar drekën)
- Mësuesit/et dhe stafi do të bëjnë pushime dhe do të hanë në zonat e caktuara të ndërtesës, siç vendoset nga drejtoria ose personi përgjegjës për mbikëqyrjen
- Takimet e stafit do të kryhen virtualisht
- Zhvillimi profesional do të kryhet virtualisht

# Lejimi i Vizitorëve/eve në Ndërtesë

**Udhëzime të Distriktit**

- Personat që do vizitojnë duhet të telefonojnë përpara dhe të përcaktojnë një orar për të hyrë në ndërtesë
- Do u kërkohet të regjistrohen me emrin, qëllimin dhe numrin e tyre të telefonit
- Vizitorët/et duhet të mbajnë maska në të gjitha kohët
- Ata/ato duhet të ruajnë distancë sociale prej dy metrash, kur të hyjnë në shkollë
- Në zyrë do të lejohet vetëm një vizitor/e në një orë
- Stafi do të ndihmojë vizitorët/et me nevojat e tyre
- Nuk do të ketë vizitorë/e vullnetarë/e në klasa

> *Vendimet për kohën dhe mënyrën e rihapjes së shkollave gjatë COVID-19 është e nevojshme të bazohen në një set të fortë primesh, të mbështetura nga të dhënat më të mira të disponueshme, informohen nga konteksti dhe të orientohet drejt aspiratave më të larta të secilit komunitet, për të mësuarin dhe mirëqenien e nxënësit/es.*
>
> *-Projekti Parabola*

# Cilësia e Ajrit dhe Protokolli i Pastrimit

**Udhëzime të Distriktit**

- Ne modernizuam të gjitha ndërtesat për të përmirësuar rrjedhën e ajrit
- Vlerësimet e HVAC u kryen në 59 lokacione
- Sistemet Jonizuese "Needlepoint Bipolar" janë instaluar në të gjitha vendet për të përmirësuar cilësinë e ajrit
- Makineri dezinfektuese janë blerë për të gjitha shkollat dhe do të përdoren çdo natë
- Pastruesit/et do të pastrojnë dhomat, zbrazin plehrat dhe do të dezinfektojnë rregullisht ato zona që preken më shumë
- Çdo klasë do të pajiset me peceta dezinfektuese për t'u përdorur në tavolina dhe materiale, për pastrim të shpeshtë; pecetat përbëhen nga dezinfektuesi më i sigurt në dispozicion në treg, i miratuar nga EPA për Covid-19
- Dezinfektanti i duarve është blerë për të gjitha shkollat dhe do të rimbushet kur të jetë e nevojshme

# Përmbledhje e Punës së Sistemit të Ventilimit




Burimi: Shërbimet Lehtësuese EMCOR
Udhëzime për Përmirësimin e Cilësisë së Ajrit në Mjedise të Brendshme me Jonizimin “Needlepoint Bipolar”
Emcorfacilities.com



## Reduktimi i Përhapjes së Sëmundjes

**Pastrimi i Shpejtë dhe i Vazhdueshëm i Ajrit** Teknologjia NPBI lëshon jone që menjëherë fillojnë të ngjiten me grimca dhe, ndërkohë që jonet hyjnë në rrjedhën e ajrit, ata ofrojnë pastrim të vazhdueshëm nëpër të gjithë objektin.

**Çaktivizimi i Patogjenëve** Kur jonet vijnë në kontakt me patogjenët, jo vetëm që i bëjnë ata më shumë të filtrueshëm, por edhe efektet e tyre mikrob-vrasëse zvogëlojnë infektivitetin e virusit.

| PATOGJENI | KOHA E EKSPOZIMIT | SHKALLA E VRASJES/ÇAKTIVIMIT |
|---|---|---|
| E. coil | 15 minuta | 99.68%* |
| C. Diff | 30 minuta | 86.50%* |
| Virusi Noro | 30 minuta | 93.50%* |
| MRSA | 30 minuta | 96.24%* |
| COVID-19 | 30 minuta | 99.40%* |

*Udhëzues që detajojnë këto rezultate janë të mundësuar, sipas kërkesës, nga prodhuesi i teknologjisë jonizuese “needlepoint bipolar”.

Burimi: Shërbimet Lehtësuese EMCOR
Udhëzime për Përmirësimin e Cilësisë së Ajrit në Mjedise të Brendshme me Jonizimin “Needlepoint Bipolar”
Emcorfacilities.com

# Transporti

**Udhëzime të Distriktit**

- Nxënësit/et duhet të mbajnë 1 metër distancë, ndërkohë që presin për të hipur dhe hipin në autobus
- Nxënësit/et duhet të shikojnë përpara gjatë gjithë kohës dhe të përmbahen nga ngrënia, të kënduarit, të bërtiturat ose të shkëmbyerit të sendeve, ndërkohë që janë në lëvizje
- Autobusët do të pastrohen dhe dezinfektohen nga një udhëtim te tjetri
- Dritaret do të qëndrojnë të hapura për sa kohë zgjat udhëtimi
- Nxënësit/et, shoferët/et dhe vëzhguesit/et duhet të mbajnë maska gjatë gjithë kohës
- Do të realizohen plane të uljes për të gjithë nxënësit/et, për çdo itinerar të autobusit, në përputhje me Udhëzimet e Transportit DESE
- Nxënësve/eve do t'u caktohen vendet dhe do të kërkohet të qëndrojnë në to




# Shërbimi i Ushqimit për Familjet

**Udhëzime të Distriktit**

- Shërbimet ushqimore, në të gjitha shkollat, do të vazhdojnë për të gjitha familjet
- Mëngjesi dhe Dreka do të shërbehen në shkollë, për të gjithë nxënësit/et
- Mëngjesi dhe Dreka do të shërbehen me modelin Merr & Ikë
- Kamionët e shpërndarjes së ushqimit do të jenë vazhdimisht të pranishëm në të gjithë qytetin




# Dhoma Mjekësore e Pritjes & Zyra e Infermierit/es për Covid-19

**Udhëzime të Distriktit**

- WPS do të bëjë të qartë dallimin midis Zyrës së Infermierëve/eve dhe një hapësire të sigurt për Covid-19
- Të gjitha shkollat do të kenë një dhomë pritjeje mjekësore për Covid-19, të ndarë nga zyra e infermierit/es
- Salla mjekësore për Covid-19 do të përdoret për nxënësit/et që paraqesin simptoma të Covid-19
- Çdo shkollë do të ketë një infermier/e dhe një person kontakti për Covid-19
- Do të ketë dezinfektim të hapësirës pas çdo nxënësi/eje që viziton zyrën e infermierit/es



# Nxënës/e dhe Staf që Shfaqin Simptoma

**Udhëzime të Distriktit**

- Ne do të përgjigjemi menjëherë dhe në mënyrë efektive kur ka ekspozim të mundshëm ndaj Covid-19
- Një individ që është simptomatik në shtëpi duhet të qëndrojë në shtëpi dhe të testohet
- Nëse një nxënës/e ose anëtar/e i/e stafit është pozitiv/e, njoftoni drejtorin/en e ndërtesës
- Nëse një nxënës/e është Covid-19 pozitiv, në shtëpi me simptoma ose në karantinë, mund të marrin pjesë në mësimin në distancë
- Një nxënës/e që është simptomatik/e në autobus do të sillet menjëherë në dhomën e pritjes mjekësore Covid-19 për vlerësim
- Një nxënës/e që është simptomatik gjatë ditës në shkollë, do të presë në dhomën e pritjes Covid-19 derisa të mund të vijë dikush ta marrë
- Nxënësit/et simptomatik/e do të kërkojnë dikë për t'i çuar në shtëpi dhe nuk do të lejohen të përdorin autobusin
- Një anëtar/e i/e stafit, i cili/e cila duket simptomatik/e në punë, do të falsë me drejtorin/en për t'u zëvendësuar dhe do të ndjekë protokollet e distriktit
- Një nxënës/e ose anëtar/e i/e stafit, i cili/e cila rezulton pozitiv, duhet të njoftojë shkollën, të ndihmojë me procedurat e distriktit për kontaktet e ngushta dhe procedurat e statusit pozitiv për Covid-19, si edhe të ndjekë udhëzimet e CDC për karantinën ose izolimin




# Protokolle për Mbyllje të Mundshme të Shkollës

**Udhëzime të Distriktit**

Në rast se evidentohen raste të shumta të Covid-19 në shkolla ose në ndërtesë, ne do të:

- konsultohemi me Departamentin Rajonal për Shëndetin Publik të Worcester (Worcester Regional Dept. Public Health Department)
- rishikojmë të dhënat specifike të shëndetit publik lidhur me COVID-19 për Worcester-in
- përcaktojmë nëse është e nevojshme të mbyllet një klasë, një kat ose e gjithë ndërtesa, për një kohë të shkurtër, duke u konsultuar me palët e interesuara të nevojshme dhe administratën e WPS, për një vendim përfundimtar
- informojmë komunitetin
- komunikojmë planin e rihapjes së ndërtesës

# Kontakte të Distriktit

Drejtore e Përgjithshme: Maureen Binienda- 508-799-3117

Zëvendës Drejtore e Përgjithshme: Susan O'Neil-508-799-3644

Drejtor për Sigurinë në Shkollë, Koordinator i Distriktit për Covid-19: Rob Pezzella-508-799-3472

Drejtor Financier dhe Oficer Operacional: Brian Allen-508-799-3401

Menaxhere e Shkollave Fillore: Marie Morse, Ellen Kelley-508-799-3264

Menaxher i Shkollës Tetëvjeçare: Tim Sippel-508-799-3264

# Burime

- Planifikimi i këtyre udhëzimeve u realizua në bashkëpunim me Projektin Parabola: http://parabolaproject.org
- Udhëzuesi DESE mbi të Mësuarin në Distancë për Persona që Flasin Anglisht (DESE Guidance on Remote Learning for English Learners) (Lëshuar më 24 Prill, 2020)
- Udhëzues për hapjen Fillestare të Shkollës në Vjeshtë (Initial Fall School Reopening Guidance) (Lëshuar më 25 Qershor, 2020)
- Shërbime të Edukimit të Veçantë (Special Education Services) (Lëshuar më 9 Korrik, 2020)
- Pyetje Frekuente (FAQs) (Lëshuar më 10 Korrik, 2020)
- Udhëzues për Hapjen e Ndërtesave në Vjeshtë dhe të Veprimeve (Fall Reopening Facilities and Operations Guidance) (Lëshuar më 22 Korrik, 2020)
- Udhëzues për Rinisjen e Transportit në Vjeshtë (Fall Reopening Transportation Guidance) (Lëshuar më 22 Korrik, 2020)
- Udhëzues për të Mësuarin në Distancë, në Vjeshtë (Fall Remote Learning Guidance) (Lëshuar më 24 Korrik, 2020)
- Udhëzues për Kurse me Kërkesa të Shtuara Sigurie (Guidance for Courses with Additional Safety Requirements) (Lëshuar më 24 Korrik, 2020)
- Protokolle për Reagime ndaj Skenarëve të Mundshëm ndaj COVID-19 në Shkolla, autobus apo në mjedise të komunitetit (Protocols for Responding to COVID-19 Scenarios in Schools, on the bus, or in community settings) (Lëshuar dhe Rinovuar më 16 Dhjetor, 2020)